



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 80/3\_prot.

Pukë, më 23 .01 .2025

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES Së KËSHILLIT BASHKIAK PUKË**  
**datë 22 .01 .2025**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 53, pika 3, shkronja "a" si dhe të nenit 56 të VKB nr. 14 datë 30.06.2020 "Rregullore e funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pukë" dhe në zbatim të vendimit të kryesise së keshillit nr. 6 date 16. 01. .2025, mbledhja e radhes e keshillit te Bashkise Puke u zhvillua më datën **22 . 01 .2025** ,ora 13-<sup>30</sup> tek salla e Këshillit të Bashkisë Pukë, me këtë rend-dite:

- 1.Per miratimin e dhenies së mandatit të Zj. Leze Ndrek Kolaj.
- 2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 27.12.2024
- 3.Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit Dhjetor 2024.
- 4.Projekt-vendim " Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetin vjetor për vitin 2026"
- 5.Projekt-vendim " Per miratimin e nivelit të pagave të administratës së Bashkisë Pukë , njësisive administrative , Institucioneve të vartësisë dhe Funksioneve të deleguara për vitin 2025"
6. Rishqyrtim i VKB nr. 55 datë 03.12.2024 " " Për miratimin e planit të mbarshimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore Gomsiqe në NJA Qerret, Pukë, të Bashkisë Pukë"
7. Projekt-vendim " Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike duke përdorur deri 6% te fondit"
8. Te tjera.

Në mbledhje morën pjesë: Drejtorja e Finances zj.Fiqirete Latifi, drejtori i burimeve njerezore z. Sokol Gjoni, shefi i sektorit të pyjeve z. Edmond Prendi, shefja e sektorit të ndihmes ekonomike zj. Lavdie Terbuni, drejtorja e menaxhimit të territorit zj. Lindita Hyseni etj.

Mbledhja filloi ne oren siç ishte njoftuar. Jane prezent ne mbledhje 10 keshilltarë dhe keshilltarja , qe do te marre mandatin , pra eshte koorumi i domosdoshem per fillimin e mbledhjes.

Mbledhjen e hapi kryetari i keshillit te Bashkise z. Gjon Gjoka., i cili prezantoi para keshillit mocionin e nje grupi keshilltaresh me nr. 125 date 22.05.2025 , ku kerkohet ahkarkimi i anetarit te keshillit te Qarkut z. Dritan Asani .dhe u kerkua te shtohet në rendin e ditës, pra u kerkua te ndryshohet rendi i dites i njoftuar. Kryetari i keshillit hodhi ne votim rendin e dites pa ndryshime dhe pas votimit **mori 6 vota pro dhe 4 vota abstenim.** Pastaj u hodh ne votim rendi i dites i ndryshuar dhe **mori 5 vota pro dhe 5 vota abstenim.** Ne keto kushte mbledhja nuk mund te vazhdonte. Duhet theksuar se ne mocion kishte firmosur dhe keshilltarja , qe do te merrte mandatin. Pasi u qetesua situata disa minuta me vone u hodh ne votim edhe nje here rendi i dites pa ndryshime. Dhe u miratua me 10 vota pro .

Ne vijim mbledhja vazhdoi me shqyrtimin e pikes se pare te rendit te dites.

1.Per miratimin e dhenies se mandatit te Zj. Leze NdreK Kolaj. Pasi u njoh keshilli me permbajtjen e shkreses se KQZ nr. 165 date 10.01.2025, komisioni i Mandateve te keshillit , i cili pasi verifikimit te mandatit dhe dokumentacionit ka hartuar raportin e komisionit te mandateve, ku kerkoi nga keshilli votimin per dhenien e mandatit te zj. Leze NdreK Kolaj.

U hodh ne votim dhe u miratua dhenia e mandatit te zj. Leze NdreK Kolaj **me 10 vota pro, 0 vota kunder dhe 0 vota abstenim.**

Pas votimit zj. Leze Kolaj beri betimin e keshilltarit ne zbatim te pikes 1 te Nenit 50 te ligjit nr.139/2015 ” Per veteqeverisjen vendore” i ndryshuar. Kryetari i keshillit lexoi tekstin sipas pikes 1 te nenit te lartpermendur, ndersa keshilltarja u shpreh me ze te larte ”Betohem! Perfundimisht keshilltarja mori mandatin

Mbledhja vijoi me piken e dyte te rendit te dite .

2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 27.12.2024 u hodh ne vote dhe u miratua **me 10 vota pro dhe 1 vote abstenim.**












U vijua me piken e trete te rendit te dites :

3.Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Dhjetor 2024.**

U hodh ne votim dhe **nuk/ u miratua me 7 vota pro dhe 4 vota abstenim.** Ketu filloi dhe reagimi negativ i grupit te keshilltareve , qe kishin prezantuar mocionin , duke kerkuar me forcë perfshirjen e mocionit ne rendin e dites ose nuk lejojme vazhdimin e mbledhjes. Ne keto kushte ne pamundesi per vijimin normal te mbledhjes kryetari i keshillit u detyrua te nderpriste mbledhjen.



Lista e këshilltareve ne mbledhjen e dates : 22.01 .2025

Emri	Mbiemri	Firma	Verejtje
1.Gjon	Gjoka		
2. Enver	Sulejmani		
3. Ndue	Lalaj		
4. Arben	Gugaj		
5. Besmira	Aliaj		
6. Shpresa	Pemaj		
7. Edmond	Luka		
8. Alfons	Gjergjaj		
9. Dritan	Asani		
10. Besar	Kuçi		
11.Aida	Cenaj		
12.Aleksander	Frroku		
13. Eduard	Gjoka		
14. Alban	Lleshi		
15. Leze	Kolaj		

sekretari  
Harbi Topani  
Harbi

